

XHAFERR XHOXHAI



Drejtore, Departamenti e Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Lindur në vitin 1963. Diplomuar për inxhinieri naftë (1990) dhe jurisprudencë(2000).

21 vite eksperience pune.

2 vitet e fundit si auditues në KLSH. Nga shtatori 2013, Drejtore departamenti auditimi.

Fusha e ekspertizes: Jurisprudenca

KLSH, MENDËSIA E TË QËNIT SHËRBESTAR¹

nga Xhaferr Xhoxhaj

Filozofia e të qën timer shërbestar në performancën publike po ngulitet në çdo punonjës të një institucioni jetik për përgjegjësinë e menaxhimit shtetëror, sikurse është Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH). KLSH i administron letrat dhe ankesat e qytetarëve me një manual të veçantë, udhëzime të Kryetarit të KLSH, ku përcaktohen gjithë veprimet që duhen ndërmarrë nga departamentet, drejtoritë dhe personat e ngarkuar për protokollimin, shpërndarjen, verifikimin dhe deri në kthimin e përgjigjes qytetarit që ankohet. Bazuar në ankesat e qytetarëve për punën audituese të disa prej prej punonjësve të KLSH, ky institucion ka marrë masa administrative dhe disiplinore deri në largimin nga detyra të dy audituesve të tij. Etika e audituesit të KLSH, institucionit më të lartë të auditimit publik në vend, është shumë kërkuese dhe dikton një qëndrim shembullor të tij. Audituesi është matësi, kontrolluesi dhe vlerësuesi i qeverisjes publike në njësitë

shtetërore që ai auditon. Si i tillë, ai nuk mund ta kryejë këtë funksion themelor, në rast se do të ishte i paaftë, apo i njollosur vetë. Ai nuk mund të shërbejë kurrësi si garant dhe vërtetues i qeverisjes së shëndetshme publike, në rast se nuk respekton kodin e etikës. Qeverisja e mirë duhet të jetë e përgjegjshme, pjesëmarrëse dhe transparente. Auditimi i qeverisjes publike (detyra e KLSH) është një funksion që i shërben llogaridhënies. Si i tillë, KLSH shton besueshmërinë e pohimeve dhe deklaratave financiare të personit apo entitetit publik që auditohet, duke ofruar njohuri të vlefshme dhe informacione për nivelin e përgjegjshmërisë së personit ose subjektit nën auditim. Auditimet mund të ndihmojnë për të frenuar korrupsionin dhe të veprojnë si një frenues i fuqishëm për të pakësuar abuzimin me paratë dhe interesat publike. Ato, nëse janë efektive, frenojnë tendencat për të devijuar burimet publike për përfitime private. Auditimet e KLSH mund të ndihmojnë të përforcojnë kornizat ligjore, financiare dhe institucionale të cilat, kur janë të dobëta, e lejojnë korrupsionin të lulëzojë. Ato mund të ndihmojnë të krijohet një kornizë ligjore dhe institucionale e parashikueshme e sjelljes së qeverisë dhe ligje të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Realisht KLSH me punën e tij mund të zvogëlojë arbitraritetin në aplikimet e rregullave dhe ligjeve financiare e administrative të Shtetit, duke ndihmuar në thjeshtimin e procedurave administrative, veçanërisht kur ato pengojnë funksionimin normal të shërbimeve publike.

Mirëqeverisja është ambient antibiotik ku korrupsioni e ka shumë të vështirë të zhvillohet. Është e qartë se korrupsioni është një çështje komplekse. Rrënjët e tij janë të bazuara në proceset shoqërore të vendit dhe në historinë kulturore, politike dhe ekonomike të tij, si dhe në traditën e zhvillimit të administratës publike. Pranohet gjerësisht se korrupsioni ka tendencë të lulëzojë aty ku institucionet janë të dobëta dhe politikat ekonomike shtrembërojnë tregun. Korrupsioni shtrembëron zhvillimin ekonomik dhe

social të një vendi, duke prodhuar zgjedhje të gabuara politikash dhe duke inkurajuar konkurrencën në ryshfet, në vend të asaj për cilësinë dhe çmimin e mallrave dhe shërbimeve publike. Eksperienca tregon se në qoftë se korrupsioni nuk përmbahet dhe nuk kontrollohet, ai do të rritet dhe do të pjellë një model të suksesshëm ryshfeti, i cili institucionalizohet. Në këtë model, zyrtarët e korruptuar kanë gjithmonë një nxitje për të kërkuar ryshfete gjithnjë e më të mëdha. Rrezikohet kështu instalimi i një "kulture" të pandëshkueshmërisë. Kundër kësaj kulture(lexo "antikulture"), KLSH sot po lufton me të gjithë forcën e tij, nëpërmjet auditimeve, por edhe bashkëpunimeve për mirëqeverisjen. Me nismën e tij, ka lidhur marrëveshje me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Financave, ILDKP-në, Autoritetin e Konkurrencës dhe shoqata aktive të shoqërisë civile që luftojnë korrupsionin. Disiplina, vetëkontrolli dhe niveli i dijeve profesionale të trupës së audituesve të KLSH është rritur ndjeshëm në këta një vit e gjysmë të drejtimit nën filozofinë e të qenit shërbëtar.

ⁱ Botuar në Gazetën "Metropol" dt. 10 Maj 2013